

Bazuar ne nenin 3 pikë 3.1shkronja ( ë, h ) të Rregullores se UNMIK-ut mbi përgjegjësit dhe pushtetin e komunave nr.2000/45 , te dispozitave të Statutit të KK. Të Suharekës,të dt. 15.03.2001-nenin 19 shkronja ( ë ) qe ka te bëjë me udhëheqjen e pronës së Komunës dhe të nenit 2 të rregullores se UNMIK-ut,nr.2005/13 për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujtshme qe administrohet nga Komunat ne Kosovë si dhe nenit 39 dhe 40 te Ligjit mbi tokën ndertimore (Gaz. Zyrt. e Kosovës nr.14/80)dhe neni 9 i Ligjit mbi token ndertimore (Gaz. Zyrt. nr 9/86) Kuvendi i Komunës në Suharekë ne mbledhjen e mbajtur me dt. \_\_\_\_\_ 2007, miratoj këtë :

## **R R E G U L L O R E**

### **P ë r**

#### **(Dhënjen e trojeve ndërtimore ne shfrytëzim te përhershem)**

#### **PERKUFIZIMET**

##### **NENI 1.**

-“Dhënje e trolit ndërtimor” nënkupton tërësin e elementeve sociale,financiar edhe institucionale të procesit të sigurimit te trolit ndërtimor.

-“Bartës i të drejtës për shfrytëzim” janë të gjithë qytetaret ne menyre të barabart.

-“Pronë “ nënkupton palujtshmeri (tokë ndertimore e urbanizuar) e cila i përket fondit të Komunës dhe si e tillë është klasifikuar si pronë e paluejtshme shoqërore ne perputhje me ligjin në fuqi.

-“Afat”nënkupton periudhen e dhënjes se trolit ndertimor në shfrytëzim nga Komuna.

-“Regjistrim “nënkupton se prona e dhënë në shfrytëzim te përhershem regjistrohet zyrtarisht nga Komuna në emer të shfrytëzuesit (përfituesit),si bartës i të drejtës në pronë (shfrytëzues i pronës) ndërsa titullar i pronës mbetet Komuna.

#### **I.DISPOZITAT E PERGJITHËSHME**

##### **NENI 2.**

-Me këtë rregullore përcaktohen mënyrat e dhënjes dhe shfrytëzimit te trolit ndertimor,kushtet e shfrytëzimit,procedura e vendosjes kriteret si dhe renditja e përparsisë për dhënjen në shfrytëzim të te pronës qe disponon Komuna e Suharekës.

##### **NENI 3.**

- Trojet ndertimore perfitohen nga dhënja e tokës ndertimore në shfrytëzim të përhershem te cilat ipen konform Ligjit mbi tokën ndertimore (Gaz. Zyrt. e Kosovës nr.14/80 dhe. nr 9/86) si dhe Konform kësaj Rregulloreje.

##### **NENI 4.**